



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 765/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.12.2019 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e UKD”, me nr. REF-38954-10-10-2019, me fond limit 17,855,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 04.11.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime sh.a Durrës.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k.  
Adresa: Rr. “Siri Kodra”, ish blloku i magazinave tregtare, Tiranë.

Operatori ekonomik “Inform Albania” sh.p.k.  
Adresa: Rr. “Cerciz Topulli”, nr.17, Kashar, Tiranë.

**Autoriteti kontraktor:** Ujësjetllës Kanalizime sh.a Durrës  
Adresa: Lagjia nr. 17, Rr. “Dalip Peza”, Durrës.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave dhe të dokumentacionit të dërguar nga ankimuesit dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ankimuesit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se këta të fundit kanë paraqitur ankesë për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Ankimuesit kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesave të ankimuesve.

### II

#### Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.10.2019 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e UKD*”, me nr. REF-38954-10-10-2019, me fond limit 17,855,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 04.11.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime sh.a Durrës.

II.2. Në datën 17.10.2019, operatori ekonomik ankimues “Inpress” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, me argumentin si më poshtë vijon:

“[...]a) Në totalin e saj, numri i pajisjeve/makinerive të printimit dixhital të kërkuara (3 makineri dixhitale) nga AK, në DST, është tepër i lartë dhe nuk është në proporcion me llojin e kontratës që kërkohet të realizohet. Ky kriter i marrë sëbashku me kriterin e pikës 4, ku përcaktohet se: “...makineritë të kenë një kapacitet prej 25.000 flete A4 ditë, të printuara nga te dyja anët...”,

është jo në proporcion me me llojin e kontratës që kërkohet të realizohet. Në DST përcaktohet se numri i përafërt i faturave të printuara dhe të kërkuara nga AK për një periudhë 3-vjeçare është: 3,078,448 (tremilion e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e dyzet e tete) copë. Si rrjedhojë numri i përafërt i faturave të printuara dhe të kërkuara nga AK për një periudhë 1-mujore është përafërsisht 85 500 tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind copë. Që do të thotë se kjo sasi realizohet fare mirë vetëm nga 1 pajisje/makineri e printimit dixhital, me përmasat e kërkuara nga AK, prej 25.000 flete A4/ditë, të printuara nga te dyja anët.  $25.000 \text{ fletë A4/ditë} \times 22 \text{ ditë/pune} = 550.000$  (pesëqind e pesëdhjetë mijë) copë/muaj

Pra do të mjaftonte vetëm një pajisje e printimit dixhital, me përmasat e kërkuara nga AK, për të realizuar të gjithë sasinë e kërkuar, në më pak se 4 ditë pune, dhe jo më 22 ditë pune/muaj. Po të marrësh në konsideratë që një OE, mund të punojë edhe 26-27 ditë pune në muaj, atëherë sasinë e realizuar në një periudhë 1-mujore janë shumë më të mëdha se ato të kërkuara nga DST. Nga sa mësipër, bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartpërmendura, gjykojmë se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, në proporcion me natyrën dhe nërmasat e kontratës që do të purokurohet në zbatim të neneve 23 dhe 46 pika 1 të LPP-së.

Synimi bazë i autoritetit kontraktor duhet të jetë vërtetimi nëse subjektet ofertues zotërojnë ose jo kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës, duke lehtësuar edhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomike në procedurë, pasi ky është dhe qëllimi i ligjit dhe rregullave të prokurimit publik. Kërkesa e Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik duhet të disponojë pajisjet/makineritë "3 makineri dixhitale", ku secila prej tyre duhet të prodhojë "25.000 flete A4/ditë, të printuara nga te dyja anët"... është në kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit si dhe ul ndjeshëm konkurrencën.

Si rrjedhojë, kriteri i veçantë kualifikues: "Operatori ekonomik duhet të posedojë 3 makineri dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezerve në rast difekti)", i marrë sëbashku me kriterin: "Operatori duhet të paraqesë kartelën teknike të makinerive të printimit dixhital, nga te cilat duhet të rezultojnë se makineritë kanë një kapacitet prej 25.000 flete A4/ditë, të printuara nga te dyja anët. "... do të duhet të ndryshohet duke kërkuar: a) ose "2 makineri dixhitale me ngjyra (1 për prodhim normal dhe 1 për rezerve në rast difekti), duke lënë kështu të pandryshuar kriterin tjetër: "...makineritë të kenë një kapacitet prej 25.000 flete A4 ditë, të printuara nga te dyja anët. "... b) ose duke lënë të pandryshuar kriterin "3 makineri dixhitale 2 për prodhim normal dhe 1 për rezerve në rast difekti por duke ndryshuar/ulur ndjeshëm kapacitetin e kërkuar për prodhimin e numrit të fletëve në 1 ditë, për secilën prej pajisjeve printer dixhital,... "...makineritë të kenë një kapacitet prej 10.000 flete A4/ditë, të printuara nga te dyja anët. "

a) Pajisjet/makineritë e printimeve dhe shtypshkrimeve, në zbatim të legjislacionit shqiptar në fuqi, b) dhe Kodit Civil në veçanti, janë pasuri të luajtshme të cilat nuk kanë nevojë dhe nuk parashikohet nga legjislacioni shqiptar aktualisht në fuqi, që të regjistrohen në ndonjë Regjistër të veçantë Publik, si në rastin e automjeteve. Për këtë arsye edhe vërtetimi/provimi i zotërimit/disponimit real të këtyre pajisjeve/makinerive mund të provohet me çdo lloj dokumentacioni të nevojshëm ligjor, pasi si pronësia, ashtu edhe posedimi ligjor i këtyre pasurive të paluajtshme mund të provohet me çdo formë ligjore të parashikuara nga dispozitat e

*Kodit Civil. Për këtë arsye përshkrimi shterues që përcaktohet në pikën 3.3, “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumentave Standarte të Tenderit, ku për vërtetimin e zotërimit/posedimit/disponimit të këtyre pajisjeve/makinerive të shtypshkrimeve të kërkuara në DST, kërkohet: “...paraqitja e aturë blerje ose dokument zhdoganimi... është në kriter diskriminues dhe jo në përputhje me pikën 1/b), të nenit 46, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në veçanti, si dhe legjislacionit shqiptar në përgjithësi. Përvec mënyrave të vërtetimit/provimit të përcaktuara në DST fare mirë zotërimi/posedimi/disponimi i pajisjeve/makinerive të printimit dhe shtypshkrimit mund të provohet në mënyrë ilustruese dhe Jo-shteruese edhe me kontrata dhurimi me dokumentacion përkatës së blerjes së këtyre pajisjeve/makinerive në ankand' bilanceve të shoqërive tregtare të depozituara rregullisht pranë organeve të tatim-taksave ku këto pajisje mund të jenë rregullisht të deklaruara), etj.*

*Nga sa mësipër, bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartpërmendura, gjykojmë se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të neneve 23 dhe 46 pika 1 të LPP-së. Synimi bazë i autoritetit kontraktor duhet të jetë vërtetimi nëse subjektet ofertues zotërojnë ose jo kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës, duke lehtësuar edhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomike në procedurë, pasi ky është dhe qëllimi i ligjit dhe rregullave të prokurimit publik. Kërkesa e Autoritetit Kontraktor që operatorit ekonomik duhet të disponojë pajisjet/makineritë “... disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomikë duhet “... faturë blerje ose dokument zhdoganimi...,... është në kërkesë jo e plotë dhe shkon përtej asaj se farë është e nevojshme për realizimin e synimit si dhe ul ndjeshëm konkurrencën. Si rrjedhojë, kriteri i veçantë kualifikues: operatorit ekonomik duhet të vërtetojë me anë të deklaratave të zhdoganimit faturës tatimore të blerjes ose aktin noterial të marrjes me qera se disponon makineritë e mëposhtme: ”, do të duhet të ndryshohet, duke përfshirë, ose në mënyrë shteruese të gjitha mënyrat dhe format ligjore të zotërimit/ posedimit/disponimit të pajisjeve/makinerive të printimit dixhital të kërkuara në DST ose të përcaktojë në mënyrë ilustruese dhe Jo-Shteruese disa nga këto mënyra forma ligjore por duke vendosur në mënyrë të detyrueshme edhe fjalën “etjerë/etj.” në fund të falisë duke përfshirë kështu edhe mënyrat e tjera të vërtetimit të zotërimit/ posedimit/disponimit të pajisjeve/makinerive të printimit dixhital të kërkuara në DST sic janë edhe kontrata dhurimit dokumentacioni përkatës së blerjes së këtyre pajisjeve/makinerive në ankand, bilanceve të shoqërive tregtare të depozituara rregullisht pranë organeve të tatimtaksave ku këto pajisje mund të jenë të deklaruara etj [...]”*

II.2.1. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën, operatorit ekonomik ankimues “Inpress” sh.p.k., me anë të shkresës nr.3105prot., datë 22.10.2019, duke e pranuar pjesërisht atë, me arsyetimin si më poshtë vijon:

*“[...]1. Ne lidhje me ndryshimin e kriterit të percaktuar në kapaciteti teknik pika 2.3 shtojca 8 “Kriteret e veçanta për kualifikim”, percaktohet ; 3. Operatori ekonomik duhet të posedojë 3 makineri dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezervë në rast difekti). Të paktën 2 nga makineritë duhet të jenë me ngjyra. Disponimi 1 makinerive duhet vërtetuar me faturë blerje ose dokument zhdoganimi. Edhe në rastin e marrjes me qera nga kompani tjetër duhet paraqitur kontrata e qirasë e vlefshme bashkangjitur fatura e blerjes. 4. Operatori duhet të paraqesë kartelën teknike të makinerive nga të cilat duhet të rezultojnë se makineritë kanë një kapacitet prej 25.000 fletë A4/ditë të printuara nga të dyja anët.*

*I. Grupi i Shqyrtimit të ankesës vëren se, nga shqyrtimi i DST-ve sqarohet qëllimi i vendosjes së këtij kriteri në pikën 3 dhe 4 nga AK, i cili është vendosur në mënyrë që të përmbushet pikërisht Kërkesa e vendosur tek Specifikimet teknike pika SHERBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT, ku saktësohet se; “UKD do të dërgojë filen së parashtypur 30 ditë përpara fillimit të ciklit të radhës së printimit. Ky imazh mund të ndryshojë çdo 3 muaj. Brënda 2 ditësh nga momenti i marrjes së këtyre të dhënave Operatori duhet të përfundojë shërbimin e printimit dhe zarfimit”. Sa më sipër Grupi i shqyrtimit të ankesës vlereson se pretendimi i OE për këtë pikë nuk qendron, pasi vendosja e kriterëve të veçanta është bërë në përputhje me kërkesat e Specifikimeve teknike dhe Grafikut të lëvrimin.*

*II. Grupi i shqyrtimit të ankesës vëren se, legjislacioni Shqiptar dhe Kodi Civil i RSH njeh disa forma të vërtetimit të pronësisë, posedimit për mjetet /pajisjet si pronë e paluajtshme, sic janë kontrata dhurimi, dokumentacion i blerjes në ankandë, bilancet e shoqerive ku mjetet janë inventarizuar dhe deklaruar pranë organeve tatimore etj.*

*Sa më sipër Grupi i shqyrtimit të ankesës vlereson se pretendimi i OE për këtë pikë qendron dhe referuar rekomandimeve të APP, propozon pranimin e ankesës për këte pikë dhe propozon ndryshimin e DST dhe modifikimin e këtij kriteri si më poshtë;*

*Operatori ekonomik duhet të posedojë 3 makineri dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezervë në rast difekti). Të paktën 2 nga makineritë duhet të jenë me ngjyra. Disponimi i makinerive duhet vërtetuar me faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose çdo formë tjetër disponimi që njeh Kodi Civil i RSH. Edhe në rastin e marrjes me qera nga kompani tjetër, duhet paraqitur kontrata e qirasë e vlefshme bashkangjitur fatura e blerjes ose dokument zhdoganimi ose çdo formë tjetër disponimi që njeh Kodi Civil i RSH[...]*”

II.2.2. Në datën 25.10.2019, operatori ekonomik ankimues “Inpress” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.3. Në datën 17.10.2019, operatori ekonomik ankimues “Inform Albania” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, me argumentin si më poshtë vijon:

*“[...]1. Ne shtojcën 8 pika 6 e kriterëve të veçanta tek kapaciteti teknik 3.3 është kërkuar kriteri Operatori ekonomik duhet të ketë ambiente të sigurta dhe të ruajtura për magazinim dhe prodhim, të siguruar me kamera sigurie. Për këtë arsye duhet të paraqesë certifikatë pronësie ose kontratë qiraje të noterizuar të ambientit të vlefshme gjithë periudhën e kontratës. Konstatojmë se ky kriter është sa konfuz dhe i paqarte dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit, sepse edhe kërkon kamera sigurie në pjesën e parë të kriterit por kërkon certifikatë*

pronesie tek pjesa e dyte e kriterit. Nuk kuptojme se cfare do te vertetoje autoriteti kontraktor me certifikaten e pronesise, pronesine dhe sipërfaqen perkatese (m2) te subjektit apo do te vertetoje faktin qe operatori ekonomik disponon kamera sigurie ne kete ambjent , sepse ska sens dhe nuk qendron kjo kerkese qe ne cetifikate pronesie te vertetohet disponimi i kamerave te sigurise. Duke e percaktuar keshtu kete kerkese mendojme dhe gjykojme se ne kete menyre eshte shume i paqarte dhe nuk kuptojme kush eshte qellimi i percaktimit te ketij kriteri dhe pse kerkohe nga autoriteti kontraktor nje kerkese e tille. Nuk kuptojme kete kriter sepse autoriteti kontraktor kerkon nje ambjent te sigurt te siguruar me kamera sigurie dhe kete kerkon ta vertetoje me certifikate pronesie, nderkohe qe certifikata e pronesise eshte nje dokument apo akt qe ne baze te legjislacionit civil ne fuqi verteton vetem disponimin e nje ambjenti ne kete rast konkret dhe nuk permban te dhena te tjera si psh kamerat e sigurise etj. Ne rregullat e prokurimit publik dhe ligjin e prokurimit publik percaktohet shume qarte qe autoriteti kontraktor harton kriteret ne perputhje e perpjesetim me objektin dhe natyren e kontrates qe prokurohet si dhe jo diskriminuese. Gjithashtu eshte percaktuar ne legjislacion qe autoriteti kontraktor duhet te hartoje e percaktoj kriteret te sakta e te qarta me qellim kuptimin e tyre nga te gjitha te interesuarit madje edhe nga personat me aftesi te kufizuara. Keshtu sic eshte kerkuar ky kriter ne gjykimin tone le vend per interpretim dhe ne kete menyre mund te beje shkak per diskriminim te paligjshem gjate vleresimit dhe shqyrtimit te ofertave, prandaj kerkojme saktesimin dhe qartesimin e ketij kriteri domethene autoriteti kontraktor te percaktoj qarte se cfare kerkon dhe si e kerkon vertetimin e asaj qe kerkon pra nese autoriteti kerkon ambjent ateher te percaktoj qarte dokumentin per vertetimin e ketij ambjenti qe ne rastin konkret eshte certifikata e pronesise ose kontrata me qira dhe ne rast se kerkon ambjenti te survejuar me kamera sigurie dmth kerkon te vertetoje qe ambjenti ka kamera ateher te percaktoj qarte dokumentin qe kerkon per vertetimin e ketij fakti, ne perputhje me percaktimet ligjore ne fuqi. Sa me siper si perfundim kerkojme qe autoriteti kontraktor te percaktoj qarte kete kerkese dhe te saktesoje cfare kerkon duke percaktuar qarte edhe dokumentin me te cilin kerkon ta vertetoje. Konstatojme se formulimi i ketij kriteri eshte i paqarte dhe mund te shkaktoj konfuzion te operatorit ekonomik te interesuar. Autoritet kontraktore duhet te kujdeset qe kriteret te formulohen ne menyre sa me te qarte dhe te percaktojne dokumentet konkrete qe duhen paraqitur ne permbushje te ketyre kriterëve te kualifikimit. Ne keto kushte, autoriteti kontraktor duhet te riformuloje kriterin e sipercituar, duke e qartesuar kerkesen e mesiperme. Autoriteti kontraktor duhet te beje modifikimin e duhur per te percaktuar qartesisht kete kriter sepse te dyja fjalite e ketij kriteri vine ne konfuzion me njeri tjetrin.

2. Në dokumentat e tenderit të kësaj procedure prokurimi, objekt ankimi, autoriteti juaj kontraktor ka percaktuar qe, sherbimi i printimit dhe zarfimit te faturave do te jete per tre vite dhe afatet e ekzekutimit do te jene 36 muaj duke filluar nga dita e neserme e punes pas nenshkrimit te kontrates. Gjithashtu eshte parashikuar qe UKD do te dergojë filen për imazhin e letrës së parashtypur 30 ditë përpara fillimit të ciklit të radhës së printimit. Ky imazh mund të ndryshojë cdo 3 muaj. Brenda 2 ditësh nga momenti i marrjes së këtyre të dhënave operatori duhet të përfundojë shërbimin e printimit dhe zarfimit. Pra në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik, autoriteti kontraktor po prokuron një fond limit për tre vite së bashku, i cili sjell si pasojë rritjen artificiale të kërkesave për kualifikim, pasi ato vendosen sipas vlerës së fondit limit.

a) Autoriteti kontraktor, për fondet buxhetore, prokuron dhe financon kontratat për një periudhë, deri në mbylljen e vitit ushtrimor, me përjashtim të rastit kur lidhen kontrata shtesë.

b) Autoriteti kontraktor, nuk lidh kontrata shumëvjeçare për punë, mallra apo shërbime, për të cilat bëhen planifikim dhe përdorime vjetore që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht me një procedurë të hapur apo kërkesë me propozim.

c) Kontratat shumëvjeçare, mund të lidhen nëse, objekti i tyre është blerja ose qiraja me këste e mallrave me ose pa mundësinë e kalimit të pronësisë, shërbimeve, që zgjat deri në pagimin e plotë të vlerës, ose derisa pronësia ti kalojë AK. Është kontratë komplekse, e cila kërkon financim shumëvjeçar ose të strukturuar, e cila nuk mund të zbatohet brënda vitit ushqimor, si projektet komplekse të infrastrukturës, ku financimi është i sigurt. Gjithashtu ju bëjme me dije se në kushtet ju kërkoni për tre vite automatikisht fondi limit rritet pasi kërkoni në të njëjtën kohë për tre vite bashke. Në nenin 28 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Përcaktimi i vlerës së një kontrate publike bazohet në shumën e plotë të pagueshme pa TVSH, të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor në çastin e botimit të njoftimit të kontratës të parashikuar në nenin 38 të këtij ligji ose në çastin e fillimit të procedurës së prokurimit, në rastet kur nuk kërkohet një botim i tillë. Përlllogaritja merr parasysh shumën e plotë të vlerësuar për t’u paguar, duke përfshirë çdo formë obsioni apo rinovimi të kontratës. 2. Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj. 3. Metodat për llogaritjen e vlerës së kontratave publike përcaktohen në rregullat e prokurimit”. Në nenin 28 pika 6 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht si më poshtë: “Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur”. Në nenin 60 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: “Në nenin 60 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, është parashikuar se: “Me miratimin e ligjit për buxhetin dhe pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, kur ka nevojë për punë mallra shërbime, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë: objektin e prokurimit; -fondin e përlllogaritur të vitit ushtrimor si dhe fondin total të përlllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare; llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj; emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

Fondi limit është një ndër elementët e rëndësishëm të një procedure prokurimi që përcaktohet që në nisjen e saj, në urdhërin e prokurimit, siç përcaktohet në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe në bazë të fondit limit bëhet përzgjedhja e llojit të procedurës si dhe hartohen dokumentat standarte të tenderit. Vlera limit e kontratës publike është shuma totale, e pagueshme, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara dërgimit për botim të njoftimit të procedurës së prokurimit. Në llogaritjen e vlerës merret parasysh edhe shuma totale, që duhet paguar në rast ripërtëritjeje të kontratës, kur një gjë e tillë është parashikuar si mundësi. Autoriteti kontraktor duhet të argumentojë aplikimin e kontratës trevjeçare dhe të bëjë një përlllogaritje të saktë të fondit, ku të jepen hollësi për investimin, që do të kryhet, amortizimin për çdo vit, dhe përbërësit/elementet e tjera të ngjashme me to. Nje qendrim te ngjashem ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin KPP 136/2017 date 17.03.2017 etj. Sa me siper kerkojme uljen e kohezgjatjes se kontrates ne nje vit sipas percaktimeve ligjore ne fuqi

*duke ulur fryrjen e fondit limit dhe rritjen artificiale te kerkesave per kualifikim te cilat ne perputhje me fondit limit percaktohen edhe keto kritere. [...]*”

II.3.1. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën, operatorit ekonomik ankimues “Inform Albania” sh.p.k., me anë të shkresës nr.2285prot., datë 24.10.2019, duke e pranuar pjesërisht atë, me arsyetimin si më poshtë vijon:

*“[...]Ne lidhje me kete pike, GSHA sqaron: Ne kuptim te ketij kriteri, verejme se ndodhemi para 2 kerkesave. 1. Objekti ne te cilin ushtron veprimtarine OE duhet te jete i mbikqyrur nga kamerat e sigurise, kjo bazuar ne ligjin nr.19/2016 “Për masat shitesë të sigurisë publike” ku ne nenin 8 pika 3 shprehet “përdorimi i sistemit të kamerave CCTV.. ne cdo objekt”. 2. Objekti duhet te jete ose ne pronesi te OE, ose i marre me qira nga OE. Ne rastin kur objekti eshte ne pronesi te OE, ai duhet te paraqesi Certifikaten e pronesise se objektit dhe ne rast se objekti eshte me qera duhet qe OE te paraqesi kontraten e qirase te noterizuar. Nga sa me siper, duke qene se ne DST-e kjo kerkese eshte e paqarte, propozojme qe ky kriter te riformulohet si me poshte: “Operatori Ekonomik duhet te kete ambiente te sigurta dhe te ruajtura per magazinim dhe prodhim, te siguruara me kamera sigurie. Per plotesimin e ketij kriteri OE duhet te paraqesi veledklarim me shkrim ne te cilen shprehet se objekti eshte i mbikqyrur nga kamerat e sigurise CCTV. OE duhet te te paraqese çertifikate pronesie ose kontrate qiraje te noterizuar te ambientit ne te cilen ushtron aktivitetin, te vlefshme per te gjithë periudhen e kontrates. Nga sa me siper, ankesa e bere ne lidhje me kete pike nga OE ankimues te meret ne konsiderate.*

*Ne lidhje me kete pike, GSHA sqaron:*

*Se pari, Propcedura e prokurimit e zgjedhur nga AK per prokurimin me objekt “Sherbimi i printimit dhe zarfimit te iaunave per nevojat e UKD” me afat shumevjeçar eshte konform nenit 28/6 te VKM nr. 914 date 29.12.2014 “Per Rregullat e Prokurimit Publik“ i ndryshuar i cili shprehet: Ne rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur”. Intepretimi i bere nga ana e OE ankimues i cili shprehet se “prokurimin e fondit limit per tre vite sebashku eshte ne kundershtrim me legjislacionin e prokurimit publik” nuk qendron.*

*Se dyti. AK ka vendosur te aplikojte kontrate shumevjeçare me afat ekzekutimi 36 muaj (3 vjet). pasi nga praktikat e viteteve te mepareshme ka rezultuar qe kjo lloj procedure prokurimi ka zgjatur tej afateve kohore, kjo per shkak te ankesave te OE. Zgjatja pertej afateve e procedures se prokurimit, ka sjelle qe Shoqeria te mos realizoje nje nga objektivat e saje, mos faturimin (primimin e faturave) e abonenteve, si dhe mos arketimin ne kohe te tyre. Perlllogaritja e vleres se kontrates shumevjeçare eshte bere konform nenit 59 te VKM nr 914 date 24.12.2014. Kriteret e vendosura ne DST, jane teresisht në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet dhe nuk jane diskriminuese per OE. Vendimi i KPP me nr 136/2017 date 17.03.2017, te cilit i eshte referuar OE INFORM ALBANIA dhe i pasqyruar identik ne ankesen e tij, nuk mund te jete referues per AK, kjo pasi vete KPP ne nje vendim te sajine me nr. 912/2016 shprehet “ ..KVO nuk duhet ti referohet një Vendimi të KPP-së për një procedurë tjetër dhe me kërkesa të tjera. Së treti KVO-ja nuk e di ose nuk dëshiron të dijë që vendimet KPP-së nuk kanë karakter unifikues. Siç janë disa vendime të Gjykatës së Lartë ( nga Kolegjet e Bashkuara) dhe nuk mund*



*të merren si argumenta për vlerësimin e procedurave të ndryshme të prokurimit, sepse çdo vendim i KPP-së është i veçantë dhe i përgjigjet pretendimeve të ngritura për procedura të vecanta prokurimi nga operatorë të ndryshëm ankimues Prokurimi i kontratës së shërbimit nga AK. [...]*”

II.3.2. Në datën 30.10.2019, operatori ekonomik ankimues “Inform Albania” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentimin s më poshtë vijon:

*“[...]1. Ne lidhje me pretendimin për modifikimin e kriterit të percaktuar në shtojcën 8 pika 6 e kriterëve të vecanta tek kapaciteti teknik 3.3 ku ishte kërkuar kriteri “Operatori ekonomik duhet të ketë ambiente të sigurta dhe të ruajtura për magazinim dhe prodhim, të siguruar me kamera sigurie. Për këtë arsye duhet të paraqesë certifikatë pronësie ose kontratë qiraje të noterizuar të ambientit të vlefshme gjithë periudhën e kontratës”, AK ne shkresën kthim përgjigje për ankesën tone rezultoi se e ka pranuar ankesën tone dhe ka bërë riformulim të këtij kriteri. Kujtojmë autoritetin kontraktor që bazuar në nenin 42 të ligjit për prokurimin publik nr. 9643, datë 20.11.2006, ku percaktohet se: 1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. 2. Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë. Sa me sipër percaktuar, autoriteti kontraktor meqë ka pranuar pretendimin tone të parë me kthimin e përgjigjes të trajtimit të ankesës sone, ai duhet të bejë edhe publikimin e shtojcës në sistemin e prokurimeve elektronike me kriterin e ndryshuar dhe të riformuluar. Kërkojmë publikimin e shtojcës për modifikimin e këtij kriteri në përputhje me kriterin e formuluar në shkresën kthim përgjigje.*

*2. Për pretendimin e dytë të ngritur nga shoqëria jone autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar atë. Në ankesën e drejtuar në autoritet në kemi argumentuar si më poshtë: Në dokumentat e tenderit të kësaj procedure prokurimi, objekt ankimi, autoriteti juaj kontraktor ka percaktuar që, shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave do të jete për tre vite dhe afatet e ekzekutimit do të jene 36 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës. Gjithashtu është parashikuar që UKD do të dergojë filen për imazhin e letrës së parashtypur 30 ditë përpara fillimit të ciklit të radhës së printimit. Ky imazh mund të ndryshojë cdo 3 muaj. Brenda 2 ditësh nga momenti i marrjes së këtyre të dhenave operatori duhet të përfundojë shërbimin e printimit dhe zarfimit. Pra në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik,*

autoriteti kontraktor po prokuron një fond limit për tre vite së bashku, i cili sjell si pasojë rritjen artificiale të kërkesave për kualifikim, pasi ato vendosen sipas vlerës së fondit limit. a) Autoriteti kontraktor, për fondet buxhetore, prokuron dhe financon kontratat për një periudhë, deri në mbylljen e vitit ushtrimor, me përjashtim të rastit kur lidhen kontrata shtesë. b) Autoriteti kontraktor, nuk lidh kontrata shumëvjeçare për punë, mallra apo shërbime, për të cilat bëhen planifikim dhe përdorime vjetore që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht me një procedurë të hapur apo kërkesë me propozim. c) Kontratat shumëvjeçare, mund të lidhen nëse, objekti i tyre është blerja ose qiraja me këste e mallrave me ose pa mundësinë e kalimit të pronësisë, shërbimeve, që zgjat deri në pagimin e plotë të vlerës, ose derisa pronësia ti kalojë AK. Është kontratë komplekse, e cila kërkon financim shumëvjeçar ose të strukturuar, e cila nuk mund të zbatohet brënda vitit ushqimor, si projektet komplekse të infrastrukturës, ku financimi është i sigurt. Gjithashtu ju bëjme me dije se në kushtet ju kërkoni për tre vite automatikisht fondi limit rritet pasi kërkoni në të njëjtën kohë për tre vite bashke. Në nenin 28 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se: "Përcaktimi i vlerës së një kontrate publike bazohet në shumën e plotë të pagueshme pa TVSH, të përllogaritur nga autoriteti kontraktor në çastin e botimit të njoftimit të kontratës të parashikuar në nenin 38 të këtij ligji ose në çastin e fillimit të procedurës së prokurimit, në rastet kur nuk kërkohet një botim i tillë. Përllogaritja merr parasysh shumën e plotë të vlerësuar për t'u paguar, duke përfshirë çdo formë obsioni apo rinovimi të kontratës. 2. Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj. 3. Metodat për llogaritjen e vlerës së kontratave publike përcaktohen në rregullat e prokurimit". Në nenin 28 pika 6 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht si më poshtë: "Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përllogaritur". Në nenin 60 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: "Në nenin 60 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar, është parashikuar se: "Me miratimin e ligjit për buxhetin dhe pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë: objektin e prokurimit; fondin e përllogaritur të vitit ushtrimor si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare; llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj; emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit. Fondi limit është një ndër elementët e rëndësishëm të një procedure prokurimi që përcaktohet që në nisjen e saj, në urdhërin e prokurimit, siç përcaktohet në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe në bazë të fondit limit bëhet përzgjedhja e llojit të procedurës si dhe hartohen dokumentat standarte të tenderit. Vlera limit e kontratës publike është shuma totale, e pagueshme, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara dërgimit për botim të njoftimit të procedurës së prokurimit. Në llogaritjen e vlerës merret parasysh edhe shuma totale, që duhet paguar në rast ripërtëritjeje të kontratës, kur një gjë e tillë është parashikuar si mundësi. Autoriteti kontraktor duhet të argumentojë aplikimin e kontratës trevjeçare dhe të bëjë një përllogaritje të saktë të fondit, ku të jepen hollësi për investimin, që do të kryhet, amortizimin për çdo vit, dhe përbërësit/elementet e tjera të ngjashme me to. Nje qendrim te ngjashem ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin KPP 136/2017 date 17.03.2017 etj. Sa me siper kerkojme quen e kohezgjatjes se kontrates ne nje vit sipas percaktimeve ligjore ne fuqi

duke ulur fryrjen e fondit limit dhe rritjen artificiale te kerkesave per kualifikim te cilat ne perputhje me fondit limit percaktohen edhe keto kriteret. Ne ligjin e prokurimit publik neni 1 pika 2 percakton: "Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;" Në kreun II, Neni 9, pika 5 e të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: Ne ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 46, pika 3 percaktohet: "Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik." Sa me siper kerkojme qe Autoriteti kontraktor te ule kohezgjatjen e kontrates pasi percaktimi i tille krijon fryrje edhe per kriteret per kualifikim.

Ne kthimin e pergjigjes se ankeses sone autoriteti kontraktor nuk e ka marre fare parasysh pretendimin tone, dhe i referohet nje vendimi tjetër te KPP qe citon qe vendimet e KPP nuk jane te detyreshme per KVO e autoritetit kontraktor, por kujtojme ketu qe autoriteti kontraktor i referohet gabim kete vendimi pasi se pari ai vendim ka te beje me menyren e vleresimit te nje procedure prokurimi e cila ne thelb nuk ka qene e njejte si siuate sic duket nga konteksti i ketij vendimi, dhe nga ana tjetër kujtojme autoritetin kontraktor se qe nga viti 2017 me ligjin 47/2017 te ndryshimeve te ligjit te prokurimit publik ne nenin 19/1 eshte percaktuar: "3. Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime mbi ankesat e paraqitura para tij, duke mbajtur parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 2, të këtij ligji edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit". Pra KPP ka nje qendrushmeri ne vendimmarrjen e tij qe nga viti 2017 vendim tek i cili jemi bazuar edhe ne si Operator ekonomik dhe qe eshte nje vendim tek i cili eshte nje siuate e njejte me kete te cilen ne kemi kundërshtuar, dhe qe autoriteti kontraktor vertet nuk duhet ta dije se nuk jane vendime unifikuese, por ne momentin qe nga ana jone i vihet ne dukje nje vendim i tille, AK duhet te reagoje dhe duhet ta shohe si orientues dhe jo te kundërshtojte me nje vendim te vitit 2016 i cili eshte jashte fare kontekstit te ankeses sone, por thjesht citon me te drejte qe procedurat e prokurimit jane te ndryshme dhe KVO nuk duhet te drejtohen vendimeve te KPP duke i interpretuar dhe gjykuar apo perdorur gabim ato ne raste te ndryshme. Kthehem ne rastin tone, ku vendimi te cilit i jemi referuar eshte identik i njejte me rastin tone dhe kundërshtimi jone eshte i bazuar dhe argumentuar ne kete vendimmarrje pasi se pari skemi te bejme me procedure vleresimi sic shprehet ne vendimin e KPP te cilit i eshte referuar AK dhe padyshim qe rastet jane te ndryshme, por AK nuk ka dashur ta kuptojte vendimin e KPP te cilit ne i jemi referuar. Ne kthimin e pergjigjes AK vete e pranon qe ne cdo vit e ka zhvilluar ashtu sic pretendojme ne kete procedure prokurimi, por ngre argumenta jo bindese dhe te bazuara ligjeshisht por thjesht citon qe sjemi ne raste te ngjashme. Autoriteti kontraktor i referohet faktit se per shkak te ankesave procedura zgjatet dhe ne ndaj e bejme 3 vjet, por se pari gjykojme se AK duhet te hartojte kriteret te qarta te sakta si dhe te beje shqyrtimin dhe vleresimin e ofertave ne perputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik ne menyre qe te shmange ankesat qe mund te paraqiten, dhe nga ana tjetër fakti i berjes se procedures me afat 3 vjecar

*nuk do te shmange paraqitjen e ankesave ne fund te perfundimit te kesaj procedure dhe AK do te jete perseri ne te njejat kushte sikurse ajo te ishte procedure 1 vjecare, ndaj ky argument nuk qendron dhe nuk e justifikon fare se pse AK e do kete kontrate me afat 3 vjecar, pervec faktit, qe kemi argumentuar ne qe con ne fryrje te fondit limit dhe ne fryrje te kerkesave per kualifikim, diskriminim, pabarazi dhe jo trajtim te barabarte duke penguar pjesemarrjen e operatoreve ekonomike te interesuar, ne kundërshtim kjo me nenin 46 te LPP i cili percakton se “Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor me kete percaktim perjashton operatorët ekonomike dhe shkon drejt nje numri te kufizuar operatorësh. Ankesat nuk mund te pengohen dhe nuk mund te shkurtohen afatet apo te zgjidhet realizimi i objektivave te UKD nese kjo procedure eshte me afat 3 vjecar, pasi sic thame edhe me lart, perseri ne fund te kesaj procedure AK do te gjendet ne te njejten shtate sikur procedura te ishte me afat 1 vjecar, nese do te paraqiten ankesa ne publikimin e procedures se re. AK nuk ka dhene asnje argumentim ligjor per kete kohezgjatje ndaj kerkojme nga Komisioni i Prokurimit Publik, qe referuar edhe historikut te zhvillimit te kesaj procedure prokurimi ne te gjitha keto vite, ashtu si edhe vete autoriteti kontraktor e pranon qe ka zhvilluar, qe kjo procedure prokurimi te zhvillohet me nje afat kohezgjatje nje vjecare. Sa me siper kerkojme uljen e kohezgjatjes se kontrates ne nje vit sipas percaktimeve ligjore ne fuqi duke ulur fryrjen e fondit limit dhe rritjen artificiale te kerkesave per kualifikim te cilat ne perputhje me fondit limit percaktohen edhe keto kritere, si edhe bazuar ne kohezgjatjen e kesaj procedure prokurimi qe ky autoritet kontraktor ka zhvilluar ne te gjitha keto vite.[...]”*

II.4.Në datat 06.11.2019 dhe 15.11.2019, nëpërmjet shkresave me nr.2334/2prot., datë 05.11.2019 dhe nr.2385/2, datë 13.11.2019, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesat e operatorëve ekonomik ankimes.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Inpress” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi: “*Si rrjedhojë, kriteri i veçantë kualifikues: operatori ekonomik duhet të vërtetojë me anë të deklaratave të zhdoganimit faturës tatimore të blerjes ose aktin noterial te marrjes me qera se disponon makineritë e mëposhtme:*”, do të duhet të ndryshohet, duke përfshirë, ose në mënyrë shteruese të gjitha mënyrat dhe format ligjore të zotërimit/ posedimit/disponimit të pajisjeve/makinerive të printimit dixhital të kërkuara në DST ose të përcaktojë në mënyrë ilustruese dhe Jo-Shteruese disa nga këto mënyra forma ligjore por duke vendosur në mënyrë të detyrueshme edhe fjalën “*etjerë/etj..*” në fund të falisë duke përfshirë kështu edhe mënyrat e tjera të vërtetimit të zotërimit/ posedimit/disponimit të pajisjeve/makinerive të printimit dixhital të kërkuara në DST sic janë edhe kontrata dhurimit dokumentacioni përkatës së blerjes së këtyre pajisjeve/makinerive në

*ankand, bilanceve të shoqërive tregtare të depozituara rregullisht pranë organeve të tatimtaksave ku këto pajisje mund të jenë të deklaruarat etj”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën nr.8, pika 3.3.3 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

*” 3.Operatori ekonomik duhet të posedojë 3 makineri dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezervë në rast difekti). Të paktën 2 nga makineritë duhet të jenë me ngjyra. Disponimi i makinerikeve duhet vërtetuar me faturë blerje ose dokument zhdoganimi. Edhe në rastin e marrjes me qera nga kompani tjetër, duhet paraqitur kontrata qirasë e vlefshme bashkangjitur fatura e blerjes.”*

III.1.2. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues, si edhe informacionit të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, sqaron se: *“Sa më sipër Grupi i shqyrtimit te ankesës vlereson se pretendimi i OE për këtë pikë qendron dhe referuar rekomandimeve te APP, propozon pranimin e ankeses për kete pikë dhe propozon ndryshimin e DST dhe modifikimin e ketij kriteri si më poshtë; Operatori ekonomik duhet të posedojë 3 makinen dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezervë në rast difekti). Të paktën 2 nga makineritë duhet të jenë me ngjyra. Disponimi i makinerive duhet vërtetuar me faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose çdo formë tjetër disponimi që njeh Kodi Civil i RSH. Edhe në rastin e marrjes me qera nga kompani tjetër, duhet paraqitur kontrata e qirasë e vlefshme bashkangjitur fatura e blerjes ose dokument zhdoganimi ose çdo formë tjetër disponimi që njeh Kodi Civil i RSH”.*

III.1.3. Në lidhje me shqyrtimin që autoriteti kontraktor i ka bërë këtij pretendimi të operatorit ekonomik ankimues, KPP konstaton se autoriteti kontraktor e ka pranuar atë, duke u shprehur se ky pretendim qëndron. Megjithatë, Komisioni i Prokurimit Publik nuk mund të anashkalojë faktin se pretendimi i mësipërm është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe në lidhje me këtë të fundit nuk ka më objekt ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, por në zbatimin e këtij vendimi të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor, krahas konstatimeve të vendimarrjes së K.P.P. duhet të pasqyrojë njëherazi edhe ndryshimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit për aq sa është pranuar prej autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi: *“Si rrjedhojë, kriteri i veçantë kualifikues: “Operatori ekonomik duhet të posedojë 3 makineri dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezerve ne rast difekti) ”, i marrë sëbashku me kriterin: “Operatori duhet te paraqesë kartelën teknike të makinerive te printimit dixhital, nga te cilat duhet të rezultojnë se makineritë kanë një kapacitet prej 25.000 flete A4/ditë, të printuara nga te dyja anët. ”... do të duhet të ndryshohet duke kërkuar: a) ose ”2 makineri dixhitale me ngjyra (1 për prodhim normal dhe 1 për rezerve ne rast difekti), duke lënë kështu të pandryshuar kriterin tjetër: ”...makineritë të kenë një kapacitet prej 25.000 flete A4 ditë, të printuara nga te dyja anët.”,... b) ose duke lënë*

të pandryshuar kriterin ”3 makineri dixhitale 2 per prodhim normal dhe 1 per rezerve ne rast difekti por duke ndryshuar/ulur ndjeshëm kapacitetin e kërkuar për prodhimin e numrit të fletëve në 1 ditë, për secilën prej pajisjeve printer dixhital,... ”...makineritë të kenë një kapacitet prej 10.000 flete A4/ditë, te printuara nga te dyja anët.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr.8, pikat 3.3.3 dhe 3.3.4 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

*“3.Operatori ekonomik duhet të posedoje 3 makineri dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezervë në rast difekti). Të paktën 2 nga makineritë duhet të jenë me ngjyra. Disponimi i makinerikeve duhet vërtetuar me faturë blerje ose dokument zhdoganimi. Edhe në rastin e marrjes me qera nga kompani tjetër, duhet paraqitur kontrata qirasë e vlefshme bashkangjitur fatura e blerjes.*

*4.Operatori duhet të paraqesë kartelën teknike të makinerive nga të cilat duhet të rezultojnë se makineritë kanë një kapacitet prej 25000 flete A4/ditë të printuara nga te dyja anët”*

III.2.2. Në shtojcën nr.11, “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

*“UKD do të dergojë filen për imazhin e letrës së parashtypur 30 ditë përpara fillimit të ciklit të radhës së printimit. Ky imazh mund të ndryshojë cdo 3 muaj.*

*Brenda 2 ditësh nga momenti i marrjes së këtyre të dhenave operatori duhet të përfundojë shërbimin e printimit dhe zarfimit.*

*Afatet e ekzekutimit: 36 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontrates*

*Sasia e llogaritur është 3'078'448 cope e parashikuar për një periudhë 3 vjecare”*

III.2.3.Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me

dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Bazuar në objektin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni gjykon se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që të sigurohet se shërbimi i printimit dhe zarfimit do të kryhet sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor, si dhe brenda afatit të përcaktuar nga ky i fundit. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, Komisioni vëren se autoriteti kontraktor ka kërkuar printimin dhe zarfimin e rreth 85,512 faturave në muaj, brenda dy ditëve nga marrja e të dhënave nga autoriteti kontraktor. Për këtë arsye, Komisioni gjykon se, kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin/posedimin e dy pajisjeve për kryerjen e proceseve të printimit me kapacitet 25000 fletë A4/ditë, është një kërkesë e justifikuar dhe në përputhje me volumin e kontratës dhe grafikun e ekzekutimit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” sh.p.k. nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Inform Albania” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi: *“1. Në lidhje me pretendimin për modifikimin e kriterit të përcaktuar në shtojcën 8 pika 6 e kriterëve të vecanta tek kapaciteti teknik 3.3 ku ishte kërkuar kriteri “Operatori ekonomik duhet të ketë ambiente të sigurta dhe të ruajtura për magazinim dhe prodhim, të siguruara me kamera sigurie. Për këtë arsye duhet të paraqesë çertifikatë pronësie ose kontratë qiraje të noterizuar të ambientit të vlefshme gjithë periudhën e kontratës”, AK në shkresën kthim përgjigje për ankesën tone rezultoi se e ka pranuar ankesën tone dhe ka bërë riformulim të këtij kriteri. Kujtojmë autoritetin kontraktor që bazuar në nenin 42 të ligjit për prokurimin publik nr. 9643, datë 20.11.2006, ku përcaktohet se: 1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. 2. Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë. Sa më sipër përcaktuar, autoriteti kontraktor meqë ka pranuar pretendimin tone të parë me kthimin e përgjigjes të trajtimit të ankesës sone, ai duhet të bejë edhe publikimin e shtojcës në sistemin e prokurimeve elektronike me kriterin e ndryshuar dhe të riformuluar. Kërkojmë publikimin e shtojcës për modifikimin e këtij kriteri në përputhje me kriterin e formuluar në shkresën kthim përgjigje”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Në shtojcën nr.8, pika 3.3.6 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

*” 6.Operatori ekonomik duhet të ketë ambiente të sigurta dhe të ruajtura për magazinim dhe prodhim, të siguruara me kamera sigurie. Për këtë arsye duhet të paraqesë çertifikatë pronësie ose kontratë qiraje të noterizuar të ambientit të vlefshme gjithë periudhën e kontratës.”*

III.3.2. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues, si edhe informacionit të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, sqaron se: *“Ne kuptim të këtij kriteri, vërejmë se ndodhemi para 2 kërkesave. 1. Objekti në të cilin ushtron veprimtarinë OE duhet të jete i mbikqyrur nga kamerat e sigurise, kjo bazuar në ligjin nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” ku në nenin 8 pika 3 shprehet “përdorimi i sistemit të kamerave CCTV.. në cdo objekt”. 2. Objekti duhet të jete ose në pronesi të OE, ose i marre me qira nga OE. Në rastin kur objekti është në pronesi të OE, ai duhet të paraqesi Certifikatën e pronësisë së objektit dhe në rast se objekti është me qera duhet që OE të paraqesi kontratën e qirase të noterizuar. Nga sa më sipër, duke qene se në DST-e kjo kerkese është e paqarte, propozojmë që ky kriter të riformulohet si më poshtë: “Operatori Ekonomik duhet të ketë ambiente të sigurta dhe të ruajtura për magazinim dhe prodhim, të siguruara me kamera sigurie. Për plotësimin e këtij kriteri OE duhet të paraqesi veledëklarim me shkrim në të cilin shprehet se objekti është i mbikqyrur nga kamerat e sigurise CCTV. OE duhet të paraqesi çertifikatë pronësie ose kontratë qiraje të noterizuar të ambientit në të cilin ushtron aktivitetin, të vlefshme për të gjithë periudhën e kontratës. Nga sa më sipër, ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE ankimues të merret në konsideratë”.*

III.3.3. Në lidhje me shqyrtimin që autoriteti kontraktor i ka bërë këtij pretendimi të operatorit ekonomik ankimues, KPP konstaton se autoriteti kontraktor e ka pranuar atë, duke u shprehur se ky pretendim qëndron. Megjithatë, Komisioni i Prokurimit Publik nuk mund të anashkalojë faktin se pretendimi i mësipërm është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe në lidhje me këtë të fundit nuk ka më objekt ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, por në zbatimin e këtij vendimi të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor, krahas konstatimeve të vendimarrjes së K.P.P. duhet të pasqyrojë njëherazi edhe ndryshimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit për atë që është pranuar prej autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Inform Albania” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi: *“Pra në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik, autoriteti kontraktor po prokuroni një fond limit për tre vite së bashku, i cili sjell si pasojë rritjen artificiale të kërkesave për kualifikim, pasi ato vendosen sipas vlerës së fondit limit. a) Autoriteti kontraktor, për fondet buxhetore, prokuron dhe financon kontratat për një periudhë, deri në mbylljen e vitit ushtrimor, me përjashtim të rastit kur lidhen kontrata shtesë. b) Autoriteti kontraktor, nuk lidh kontrata shumëvjeçare për punë, mallra apo shërbime, për të cilat bëhen planifikim dhe përdorime vjetore që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht me një procedurë të hapur apo kërkesë me propozim. c) Kontratat shumëvjeçare, mund të lidhen nëse, objekti i tyre*



është blerja ose qiraja me këste e mallrave me ose pa mundësinë e kalimit të pronësisë, shërbimeve, që zgjat deri në pagimin e plotë të vlerës, ose derisa pronësia ti kalojë AK. Është kontratë komplekse, e cila kërkon financim shumëvjeçar ose të strukturuar, e cila nuk mund të zbatohet brënda vitit ushqimor, si projektet komplekse të infrastrukturës, ku financimi është i sigurt. Gjithashtu ju bëjme me dije se në kushtet ju kërkon për tre vite automatikisht fondi limit rritet pasi kërkon në të njëjtën kohë për tre vite bashke. Në nenin 28 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Përcaktimi i vlerës së një kontrate publike bazohet në shumën e plotë të pagueshme pa TVSH, të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor në çastin e botimit të njoftimit të kontratës të parashikuar në nenin 38 të këtij ligji ose në çastin e fillimit të procedurës së prokurimit, në rastet kur nuk kërkohet një botim i tillë. Përlllogaritja merr parasysh shumën e plotë të vlerësuar për t’u paguar, duke përfshirë çdo formë obsioni apo rinovimi të kontratës.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në seksionin nr.2, pika 2.3 “Objekti i kontratës”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

” 2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po  Jo  X”

III.4.2. Në seksionin nr.2, pika 2.8 “Objekti i kontratës”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

” Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër

1.Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës: 17'855'000 (shtatembedhjetë milion e teteqind e pesedhjetë e pese mije) Leke pa T.V.SH

2.Sasia e llogaritur është 3'078'448 cope e parashikuar për një periudhë 3 vjecare.

3.Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi është \_\_\_\_\_

4.Burimi i Financimit Fondet e UKD

5.Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër “Sherbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e UKD””

III.4.3. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues, sqaron se: “AK ka vendosur të aplikojë kontrate shumëvjeçare me afat ekzekutimi 36 muaj (3 vjet). pasi nga praktikat e viteteve të mëparshme ka rezultuar që kjo lloj procedure prokurimi ka zgjatur tej afateve kohore, kjo për shkak të ankesave të OE. Zgjatja përtej afateve e procedurës së prokurimit, ka sjelle që Shoqëria të mos realizojë një nga objektivat e sajë, mos faturimin (primimin e faturave) e abonenteve, si dhe mos arketimin në kohë të tyre.”.

III.4.4. Në nenin 76, pikat 2 dhe 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]2.Autoriteti kontraktor nuk lidh kontrata shumëvjeçare për punë, mallra ose shërbime, për të cilat bëhen planifikim dhe përdorime vjetore që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht me një

*procedurë të hapur ose kërkesë për propozim; 3.Vetëm në rrethana të argumentuara, të shpallura në njoftimin e kontratës, që lidhen ngushtësisht me natyrën, kompleksitetin dhe financimin e saj, autoriteti kontraktor mund të lidhë një kontratë shumë vjecare, nëse:*

*- objekti i tyre është blerja, qiraja ose blerja me këste e mallrave, me ose pa mundësinë e kalimit të pronësisë, shërbimeve, që zgjat deri në pagimin e plotë të vlerës ose derisa pronësia t'i kalojë autoritetit kontraktor;*

*- është kontratë komplekse, që kërkon financim shumëvjeçar ose të strukturuar, e cila nuk mund të zbatohet brenda vitit buxhetor (si për shembull, projektet komplekse në infrastrukturë) dhe ku financimi i saj është i garantuar.*

III.4.5. Referuar dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, sqarimeve të autoritetit kontraktor, si dhe përcaktimeve në dispozitën e sipërcituar, Komisioni gjykon se, prokurimi i kontratës për shërbimin dhe zarfimin e faturave, për një periudhë 3 vjecare, është i pajustificuar nga autoriteti kontraktor, në kuptim të nenit 76, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi shërbimi objekt prokurimi është vjetor, gjendet lehtësisht në treg, si dhe mund të prokurohet normalisht me një procedurë të hapur ose kërkesë për propozim. Komisioni sqaron se, nuk ndodhemi në asnjë nga rastet e përcaktuara në nenin e sipërcituar, apo të marrëveshjes kuadër, në mënyrë që ky shërbim të prokurohej me kontratë shumëvjecare. Nga ana tjetër, vlen të theksohet se zgjatja e afateve kohore për shkak të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomik, nuk përbën shkak për të shmangur detyrimet që rrjedhin nga përcaktimet e nenit 76, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të anullojë procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e UKD*”, me nr. REF-38954-10-10-2019, me fond limit 17,855,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 04.11.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime sh.a Durrës.
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inform Albania” sh.p.k., për procedurën e prokurimit e sipërcituar.

3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomik ankimues “Inpress” sh.p.k. dhe “ Inform Albania ” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1666 Protokoli, Datë 25.10.2019;      Nr. 1681 Protokoli, Datë 30.10.2019**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**